



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, bazuar në vendimin e Presidentes të Republikës së Kosovës të datës 10.12.2022, Nr.09/1637/2022, për shtyrjen dhe caktimin e datës së re të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendet e Komunave : Zveçan dhe Leposaviq, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 11.12.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Pezullimin e të Gjitha Aktiviteteve për Organizimin e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, si dhe Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq

- I. Pezullohen të gjitha aktivitetet për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, të datës 18.12.2022, si dhe zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq, të datës 25.12.2022.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 11.12.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Kreshnik Radonjic
